

**METODOLOGJIA
PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TE RRJETIT TË
TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Pjesa I – Termat e përgjithshëm

1. Autoriteti

Kjo metodologji e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit është hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

2. Qëllimi dhe fusha e aktivitetit

Qëllimi i kësaj metodologjie është vendosja e rregullave për llogaritjen e tarifave të aksesit dhe përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatori i rrjetit të gazit, siç parashikohet në nenin 32, pika 1 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” (tarifat e rrjetit). Tarifat e rrjetit do të vendosen nga operatori i rrjetit të gazit në përputhje me këtë metodologji. Kjo metodologji nuk trajton tarifat e aksesit dhe përdorimit të TAP (Trans Adriatic Pipeline).

3. Termat e përdorur në këtë metodologji

Termat e përgjithshëm të përdorur në këtë metodologji janë marrë nga Ligji Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Ato kanë kuptimet e mëposhtme:

3.1 **“Periudha rregullatore”** e llogaritjes do të thotë periudha e aktivitetit të operatorit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror e cila zgjat 12 muaj dhe përkon me vitin kalendarik.

3.2 **“Operator i kombinuar”** konsiderohet kur e njëjta shoqëri e gazit natyror liçencohet për të kryer veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operatorit të impianteve të GNL-së dhe/ose të impianteve të depozitimit, siç përcaktohet në nenin 80 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

3.3 **“Rrjet”** është një sistem i ndërlidhur tubacionesh.

3.4 **“Operator i rrjetit”** do të thotë operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operator i sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.

Të gjitha termat e përdorura në këtë Metodologji kanë të njëjtin kuptim me përcaktimet e Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

4 Parimet bazë të vendosjes së tarifave

- 4.1 Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR. Operatorit të rrjetit do t’i lejohet të mbulojë kostot e justifikuara për rrjetin si dhe një kthim mbi investimin.
- 4.2 Operatori i kombinuar do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllim të përcaktimit të tarifave nga ERE. ERE do të miratojë tarifat e rrjetit kur plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie. Tarifat e përdorimit të rrjetit të aprovuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1 vjeçare).
- 4.3 Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit.
- 4.4 Tarifat e rrjetit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të rrjetit të cilat do të konstatohen dhe trajtohen në përputhje me nenet 7– 12 të kësaj metodologjie. Kostot dhe tarifat e rrjetit do të llogariten në bazë të të dhënave të përfituara nga viti i mëparshëm i aktivitetit të operatorit të rrjetit (sipas nenit 80), por mund të merret parasysh edhe informacioni i përfituar në vitin aktual, në rast se vlerësohet i besueshëm.

Kostot e rrjetit do të llogariten si më poshtë:

$$GC_t = C_{t-2} + D_{t-2} + ROC_{t-2} - CRI_{t-2} + OCP_t$$

Ku:

GC_t	Kostot vjetore të rrjetit për vitin në shqyrtim
C_{t-2}	Elementët e kostos të vitit (t-2) si përcaktohet në nenin 8
D_{t-2}	Amortizimi I vitit (t-2) si përcaktohet në nenin 9
ROC_{t-2}	Kthimi mbi kapitalin e vitit (t-2) si përcaktohet në nenin 10
CRI_{t-2}	Të ardhurat e zbritshme të vitit (t-2) si përcaktohet në nenin 11
OCP_t	Axhustimet e periudhave të ndryshme në vitin (t) si përcaktohet në nenin 12

4.5 Vendorsja e tarifave të rrjetit do të bazohet në këto parime:

1. Tarifat e rrjetit do të pasqyrojnë kostot
2. Tarifat e rrjetit do të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës rregullatore, diferenca ndërmjet kostove reale të rrjetit (të ardhurave të realizuara) dhe atyre të lejuara nëpërmjet tarifës të jetë sa më e vogël.
3. Nuk lejohen subvencionime ndërmjet klasave të ndryshme të klientëve.
4. Tarifat e rrjetit duhet të pasqyrojnë kostot aktuale të shërbimit për çdo klient dhe duhet të alokohen në mënyrë sa më të drejtë.
5. Tarifat e rrjetit duhet të japin sinjalet e duhura për përdorimin me efikasitet të rrjetit.

6. Shpenzimet e lejuara në tarifë duhet të jenë transparente për të gjithë pjesëmarrësit.
7. Tarifat e rrjetit duhet t'i lejojnë operatorit të rrjetit të përfitojë normën e lejuar të kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve të miratuar nga ERE.
8. Tarifat e rrjetit duhet të mbeten të qëndrueshme në kohë.

5. Periudha rregullatore e llogaritjes

- 5.1 Metodologjia parashikon një periudhë llogaritjeje afatshkurtër në vend të një periudhe rregullatore afatgjatë. Kjo qasje mundëson aplikimin e tarifave vjetore për operatorët e rrjetit. Kjo siguron që kostot e larta dhe luhatjet e tyre për shkak të rritjes së infrastrukturës së gazit në Shqipëri të mund të përfshihen në llogaritjet e kostove të rrjetit.
- 5.2 Periudha rregullatore e llogaritjes duhet të jetë e njëjtë si për rrjetet e transmetimit ashtu edhe ato të shpërndarjes si saktësohet tek përkufizimet e kësaj metodologjie.

6. Dokumentat e veçanta për aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes

- 6.1 Operatori i rrjetit që operon në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes duhet të mbajë evidenca të veçanta për asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e transmetimit dhe shpërndarjes mbi baza vjetore. Këto evidenca do të shërbejnë si pjesë e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë.
- 6.2 Evidencat vjetore të veçanta për aktivitetin e transmetimit duhet të përmbajnë të gjitha asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e lidhura me aktivitetin e transmetimit.
- 6.3 Evidencat vjetore të veçanta për aktivitetin e shpërndarjes duhet të përmbajnë të gjitha asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e lidhura me aktivitetin e shpërndarjes.
- 6.4 Alokimi i aseteve, detyrimeve, të ardhurave apo kostove duhet të bëhet mbi bazën e një metode të përshtatshme shpërndarjeje.

Pjesa II – Llogaritja e tarifave të rrjetit

7. Parimet e llogaritjes së kostove të rrjetit

Kostot e vërejtura dhe të shfaqura në pasqyrat financiare të operatorit të rrjetit do të merren parasysh deri në masën që ato përkojnë me kostot që do të kishte një operator rrjeti eficient dhe i mirëmenaxhuar dhe që do të shmangte shpenzimet e tepërta. Rregullatori ka të drejtën të shqyrtojë nivelin e kostove të raportuara nga operatori i rrjetit

7.1 Kostot e rrjetit do të përcaktohen pasi të bëhen analizat përkatëse, bazuar në llogarinë humbje/fitime të aktivitetit të vitit paraardhës, pas mbylljes së tij. Siç po përmendim në këtë paragraph, kostot e rrjetit do të jenë ato aktuale, sipas nenit 8, ato të amortizimit sipas nenit 9, ato të kthimit mbi kapitalin sipas nenit 10 dhe të ardhurave të zbritshme nga ato të lejuara sipas nenit 11.

7.2 Operatori i rrjetit do të marrë në konsideratë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit njësoj sikur t'i kryente vetë ato. Operatori i rrjetit duhet që për secilën nga këto kosto të paraqesë dokumenta dhe prova.

7.3 Nëse ndodhin shpenzime apo të ardhura të jashtëzakonshme, ato duhet t'i raportohen pa vonesë rregullatorit.

8. Kostot aktuale

Zërat e kostove të pasqyruara tek PASH (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve) si për aktivitetin e transmetimit, ashtu edhe atë të shpërndarjes së gazit natyror do të merren parasysh në përcaktimin e kostove të rrjetit. Me kosto aktuale kuptojmë kostot direkte të operimit (kostot e personelit dhe ato materiale), kostot indirekte të operimit (mirëmbajtje, shërbime, riparime dhe të tjera) si dhe shpenzime të përgjithshme (qira, siguracione dhe kosto energjie dhe të tjera). Amortizimi dhe interesi mbi borxhet nuk do të pasqyrohet tek kostot aktuale të operimit, pasi ato do të pasqyrohen në kostot e aktivitetit sipas neneve 9 dhe 10. ERE do të vlerësojë nëse këto kosto janë të arsyeshme dhe të justifikuara.

9. Amortizimi i lejuar

9.1 Për të mundësuar një operim afatgjatë, të besueshëm dhe të sigurt të rrjetit, do të llogarisim rënien në vlerë të aseteve të nevojshme për operimin e rrjetit, si rezultat i vjetërimit (amortizimit) të tyre, si përshkruhet në nenet 2 dhe 4. Prandaj në llogaritjen e kostove do të përfshijmë edhe kostot e amortizimit të cilat raportohen në PASH (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve).

9.2 Amortizimi i aseteve do të llogaritet bazuar në koston e tyre historike sipas metodës së amortizimit linear.

9.3 Amortizimi i secilit aset do të llogaritet çdo vit bazuar në jetëgjatësinë e tij. Jetëgjatësia e çdo asemi nuk do të ndryshojë për periudhat e mbetura të llogaritjes së amortizimit. Llogaritja e amortizimit do të bëhet mbi baza vjetore. Për qëllim të llogaritjes së amortizimit, çdo aset I ri do të njihet si shtesë vetëm për periudhën e vitit që është vënë në shfrytëzim. Jetëgjatësitë përkatëse janë të përcaktuara në aneksin 1.

9.4 Pas përfundimit të periudhës së amortizimit të një asemi vlера e tij do të konsiderohet zero. Nuk lejohet rivlerësim i këtij asemi.

10. Kthimi i lejuar mbi bazën e rregulluar të aseteve

- 10.1 Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve të operatorit të rrjetit do të llogaritet sipas formulës :

$$R = RAB \times WACC$$

$$RAB_t = RV_{t-2} + CA_{t-2} + L_{t-2} + AUC_{t-2} - P_{t-2} - AP_{t-2} - TP_{t-2} - OL_{t-2}$$

Ku

RV_{t-2}	vlera e mbetur e aseteve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin e rrjetit të llogaritura me koston historike të blerjes apo prodhimit në fillim të periudhës rregullatore në vitin (t-2) (pas zbritjes së shumës së amortizimit të aseteve).
CA_{t-2}	vlera sipas bilancit e aseteve qarkulluese të nevojshme për operimin e rrjetit në vitin (t-2) (Kapitali i Punës)
L_{t-2}	vlera e tokës sipas çmimit të blerjes në vitin (t-2)
AUC_{t-2}	parapagimet dhe asetet në ndërtim (investimet në proces) në vitin (t-2)
P_{t-2}	provizionet në vitin (t-2)
AP_{t-2}	pagesat e marra në avancë si dhe parapagimet (paradhëniet) nga klientët në vitin (t-2).
TP_{t-2}	llogari të pagueshme mbi të cilat nuk paguhet interes në vitin (t-2)
CG	vlera e aseteve të përfituara nëpërmjet dhurimit.
OL_{t-2}	të tjera të pagueshme deri në masën e fondeve në dispozicion të operatorit të rrjetit dhe që mbi të cilat nuk llogaritet interes në vitin (t-2)

Në çdo rast do të merret parasysh mesatarja e vlerës në fillim dhe në fund të vitit.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, *provizionet* janë detyrime të papërcaktuara në vlerë dhe kohë. Zakonisht vlerësohen me vlerën e arësyeshme që një subjekt paguan në mënyrë që të mbyllë një detyrim në fund të periudhës raportuese apo t'ja transferojë atë një pale të tretë. Në vlerësimin e një provizioni merren parasysh risqet dhe pasiguritë.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, aktivet qarkulluese do të llogariten deri në një shumë të nevojshme për operimin e rrjetit. Operatori i rrjetit duhet të paraqesë në ERE një studim për fondet e kërkuara për mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të lëndëve të para, materialeve apo mjeteve monetare për përballimin e detyrimeve korrente apo mbajtjen e rezervave minimale. Në rast se një studim i tillë nuk është i mundur, operatori i rrjetit mund të paraqesë një vlerësim të përafërt të aktiveve korrente me një arsyetim me shkrim për këtë vlerësim të përafërt. Në çdo rast, aktivet qarkulluese nuk duhet të tejkalojnë vlerën e 1/12 të shpenzimeve operative (OPEX) për një periudhë të dhënë rregullatore.

10.2 Operatori i rrjetit duhet të paraqesë dokumentat dhe faktet e nevojshme për këtë qëllim.

10.3 Kthimi mbi kapitalin do të llogaritet në bazë të Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC). Baza e rregulluar e aseteve (RAB) do të shumëzohet me WACC. Llogaritja do të bazohet mbi një strukturë kapitali prej 60% borxh dhe 40% kapitale të vetat. Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit llogaritet si më poshtë:

$$WACC = [ES * ARoE / (1 - T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

ES norma që synohet për raportin e kapitalit e vet Shoqërisë në RAB (40%)

T norma e taksës së Korporatës

ARoE kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet (pas taksave)

DS norma që synohet për raportin e borxhit në RAB (60%)

CoD kostoja e borxhit

10.4 Kthimi i lejuar mbi kapitalin pas taksave merret norma bazë e interesit si dhe një premium për riskun specifik të operatorit të rrjetit. Norma bazë e interesit merret vlera mesatare 5 vjeçare e mesatares së ponderuar të obligacioneve qeveritare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

10.5 Për të llogaritur riskun specifik të operatorit të rrjetit, në mënyrë të veçantë duhet të merren parasysh faktet e mëposhtme:

1. Gjendja e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të gazit natyror si dhe vlera e operatorëve të rrjeteve të gazit natyror në këto tregje.
2. Kthimi mesatar mbi kapitalin i operatorëve të rrjeteve të gazit në tregjet e huaja.
3. Risku aktual dhe i matshëm i biznesit.

10.6 Kthimi mbi kapitalin pas taksave do të vendoset nga ERE. Herën e parë, ky vendim duhet të merret dhe të publikohet në fillim të vitit në të cilin operatorët e rrjetit fillojnë aktivitetin dhe në vazhdim, çdo tre vjet.

10.7 Norma mesatare e interesit mbi huanë e përdorur për llogaritjen e WACC do të merret mesatarja 5 vjeçare e normave mesatare vjetore të interesit të huave të reja në lekë për prona të patundshme të Korporatave private jofinanciare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

11. Të ardhura të tjera të zbritshme

Të ardhura të tjera mund t'u zbriten kostove të rrjetit me kusht që këto të ardhura duhet të burojnë nga shfrytëzimi i rrjetit dhe në mënyrë të veçantë t'i referohen këtyre elementëve të fitimit të lidhura me shfrytëzimin e rrjetit.

1. Puna e vetkapitalizuar (own work)
2. Të ardhurat nga interesi dhe investimet
3. Kostot e lidhjes në rrjet
4. Të ardhura të tjera të pasqyruara në llogarinë Fitim/Humbje pasi i janë nënshtruar gjyqimit të ERE-s (Të ardhura të tjera të lidhura me aktivitetin e licensuar)

12. Axhustimi i periudhave të mëparshme rregullatore

Pas mbylljes së periudhës rregullatore, operatori i rrjetit duhet të llogarisë diferencën ndërmjet:

1. Të ardhurave të fituara nga tarifat e rrjetit gjatë periudhës në fjalë;
2. Të ardhurave të lejuara për të njëjtën periudhë.

Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 të këtij neni tejkalojnë ato të lejuara sipas pikës 2, kjo diferencë llogaritur me një normë të caktuar interesi mbi mesataren e këtyre diferencave duhet t'u zbritet të ardhurave të realizuara sipas tarifave të miratuara dhe do të reflektohet në ulje të kostove.

Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 janë më pak se ato të llogaritura sipas pikës 2, kjo diferencë e llogaritur me një normë të caktuar interesi mbi mesataren e këtyre diferencave, norme interesi e cila do të llogaritet sipas parashikimeve të nenit 10, paragrafi 7 dhe do të reflektohet në rritje të kostove.

Kjo diferencë në rritje apo në zbritje do të kompensohet përgjatë tre periudhave të njëpasnjëshme llogaritjeje. Kjo shumë do të llogaritet si mesatare diferencash ndërmjet të ardhurave dhe kostove të periudhave përkatëse.

Pjesa III – Tarifat e rrjetit të Transmetimit

13. Llogaritja e kostove të rrjetit të transmetimit

13.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të llogarisë kostot e rrjetit të transmetimit në përputhje me nenet 7 – 12 të kësaj metodologjie.

13.2 Llogaritja e kostove të rrjetit të transmetimit duhet të bazohet në llogaritë e ndara të aktivitetit të transmetimit sipas kapitullit 6 të kësaj metodologjie.

13.3 Llogaritja e kostove të rrjetit të transmetimit do të përfshijë gjithashtu asetet dhe kostot që lidhen me matjen në sistemin e transmetimit. Kostot e matjes në rrjetin e transmetimit janë kostot e matjes dhe ato administrative të lidhura me matjet në transmetim sipas një metode të përshtatshme alokimi.

14. Rregulla të veçanta për vendosjen e tarifave të transmetimit

14.1 Kostoja e rrjetit të transmetimit do të mbulohet plotësisht nga tarifat e kapacitetit të rrjetit të transmetimit.

14.2 Operatori i rrjetit të transmetimit do të vendosë çmime të kapacitetit mbi baza vjetore, tremujore, mujore, ditore dhe, nëse është e zbatueshme edhe brenda ditës. Tarifa për një produkt të caktuar do të përfshijë të gjitha shërbimet ndihmëse të lidhura me të.

14.3 Produktet mbi baza kapaciteti do të llogariten sipas një metodologjie me çmim reference. Të njëjtat metoda me çmime reference do të bazohen në të gjitha pikat hyrëse dhe dalje të rrjetit të transmetimit. Aplikimi I metodave të çmimit të referencës duhet të përputhet me parimet e vendosura në nenin 4.5 të kësaj Metodologjie.

14.4 Tarifa për pikat hyrëse dhe dalje të rrjetit të transmetimit përbëhen nga një tarifë kapaciteti (lekë/kW). Tarifa e kapacitetit do të publikohet si për kapacitetet e qëndrueshme ashtu edhe ato me ndërprerje. Çmimi I kapacitetit me ndërprerje duhet të reflektojë probabilitetin e ndërprerjes.

14.5 Tarifat do të vendosen për çdo pikë hyrëse dhe dalje në mënyrë të veçantë në rrjetin e transmetimit.

14.6 Tarifa nuk do të varet nga niveli i presionit apo distance nga pika e hyrjes së gazit deri në pikën e saj dalje.

14.7 Tarifat e matjes do të vendosen për çdo pikë hyrëse dhe dalje të rrjetit të transmetimit. Tarifat e matjes mbulojnë instalimin, mirëmbajtjen dhe ndërrimin e matësive (duke përfshirë kostot kapitale) si dhe leximin dhe përpunimin e të dhënave. Këto tarifa duhet të pasqyrojnë kostot përkatëse.

14.8 Operatori I Rrjetit të Transmetimit mban të dhëna të detajuara të metodave të llogaritjes së tarifave në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për përdoruesit dhe palët e treta të interesuara si dhe këto të dhëna paraqiten me kërkesë të ERE-s.

PJESA IV – Tarifat e Rrjetit të Shpërndarjes

15. Llogaritja e Kostove të Rrjetit të Shpërndarjes

15.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të llogarisë kostot e rrjetit të Shpërndarjes në përputhje me nenet 7 – 12 të kësaj Metodologjie.

15.2 Llogaritja e ksotove të rrjetit të shpërndarjes bazohet në dokumenta të mbajtura mbi baza vjetore për këtë qëllim dhe që lidhen me aktivitetin e shpërndarjes sipas kapitullit 6 të kësaj Metodologjie.

15.3 Llogaritja e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përfshijë edhe asetet apo kostot që lidhen me matjen në rrjetin e shpërndarjes. Kostot e matjes në rrjetin e shpërndarjes janë kostot e matjes dhe ato administrative që lidhen me matjen në rrjetin e shpërndarjes mbi bazën e një metode të përshtatshme alokimi.

16 Rregulla të veçanta për vendosje e tarifave të Shpërndarjes

16.1 Kostoja e rrjetit të shpërndarjes do të përballohet plotësisht nga tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes.

16.2 Tarifat e rrjetit në pikat dalëse të rrjetit të shpërndarjes do të përbëhen nga një komponent vjetor kapaciteti (Lekë/kW) dhe një komponent vjetor energjie (Lekë/kWh). Komponenti vjetor i kapacitetit përfitohet duke shumëzuar tarifën e kapacitetit me kapacitetin maksimal të shfrytëzimit në pikën dalëse të rrjetit në vitin ushtrimor. Komponenti vjetor i energjisë përfitohet duke shumëzuar tarifën e energjisë me sasinë e energjisë së konsumuar në vitin ushtrimor.

16.3 Për shitjet pa profil ngarkese në rrjetin e shpërndarjes, në vend të një tarife kapaciteti dhe energjie, do të përdoret vetëm një tarifë energjie e matur në Lekë/kWh. Deri sa të vendoset një tarifë mujore (Lekë/Muaj), ky çmim baze dhe tarifa e energjisë duhet të jenë në raporte të arsyeshme me njëra tjetrën. Tarifa që rezulton nga çmimi bazë dhe tarifa e energjisë duhet të jenë raporte të arsyeshme me tarifën që do të paguajë në rast të një shpërndarje mbi bazë të profilit të ngarkesës bazuar në të dhënat e kërkesës për kapacitet dhe energji në përputhje me profilin standart të ngarkesës së përdoruesve të rrjetit.

16.4 30% e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e energjisë dhe 70 % e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e kapacitetit. Tarifat e kapacitetit do të varen nga ngarkesa maksimale vjetore ndërsa tarifat e energjisë, nga konsumi vjetor i saj.

Pjesa V – Dispozitat Përfundimtare

17 Afatet e paraqitjes së aplikimit dhe miratimi

17.1 Bazuar në këtë metodologji, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se 6 muaj para hyrjes së tyre në fuqi (t-1)

17.2 Në aplikim, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat e nevojshme për kostot e rrjetit dhe tarifat e vitit paraardhës për të cilin janë mbyllur pasqyrat financiare (t-2)

17.3 Pasi të marrë vendimin, ERE do t'ja njoftojë atë operatorit të rrjetit deri në fund të Nëntorit të atij viti. Operatori i rrjetit i publikon këto tarifa në faqen e tij të internetit tre ditë pasi është njoftuar. ERE do të publikojë vendimin e saj në faqen e saj të Internetit.

18 Kërkesat për Publikim

18.1 Operatori i rrjetit është i detyruar të publikojë tarifat e rrjetit në faqen e tij të internetit si dhe të japë informacion me shkrim sipas kërkesës.

18.2 Për më tepër, operatori i rrjetit, në datë 1 Prill të çdo viti duhet të publikojë këto karakteristika të rrjetit :

1. Gjatësia e gazsjellësit ndarë sipas niveleve të presionit (i ulët, i mesëm, i lartë) në 31 Dhjetor të vitit parardhës;
2. Gjatësia e gazsjellësit në nivel të lartë presioni ndarë sipas llojeve të diametrit të tubacionit;
3. Energjia vjetore (në kWh apo m³) lëvruar shpërndarësve dhe klientëve fundorë në vitin paraardhës;
4. Numri i pikave hyrëse dhe dalëse për çdo nivel presioni;
5. Maksimumi i kërkesës vjetore për të gjitha pikat e lëvrimin në MW apo m³ për orë si dhe koha në të cilën ndodh.

19 Dokumentacioni

19.1 Me vendosjen e tarifave, operatori i rrjetit do të përgatisë një raport në lidhje me këto tarifa. Raporti duhet të përmbajë:

1. Një përshkrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e mbyllur ushtrimore;
2. Një pasqyrim të plotë të metodës së llogaritjes së tarifave të rrjetit si dhe shpjegime të tjera plotësuese në lidhje me këto tarifa;
3. Raporti i plotë i auditimit të pasqyrave financiare si dhe dokumenta të tjera plotësuese.

19.2 Ky raport do të ruhet për një periudhë 10 vjeçare.

20 Monitorimi, vlerësimi dhe të drejtat e ERE-s.

20.1 ERE vazhdimisht monitoron vendosjen e tarifave nga operatori i rrjetit. 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, ERE vlerëson përshtatshmërinë dhe funksionimin e metodologjisë dhe publikon një raport në lidhje me statusin e mëtejshëm të kësaj metodologjie. Raporti përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me investimet e operatorit të rrjetit, efektshmërinë si dhe masat e marra për shmangjen e barrierave në lidhje me investimet.

20.2 Në këtë raport ERE mund të propozojë, ndër të tjera:

1. Heqjen e barrierave për investimet;

2. Zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së tarifave;
3. Zhvillimin e rregullave të mëtejshme në lidhje me transparencën e metodologjisë së tarifave;
4. Hartimin e një metodologjie të re tarifash (p.sh: nëpërmjet mekanizmave nxitës)
5. Hartimin e metodologjive të veçanta për aktivitetet e operimit të rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes;

21 Dispozita tranzitore

21.1 Nëse ndodh që tarifat e llogaritura në bazë të kësaj metodologjie tejkalojnë mesataren e tarifave të rrjetit në vendet fqinje dhe si rrjedhojë çmimet e gazit të klientëve fundorë nuk janë konkurrues krahasuar me burimet e tjera të energjisë, llogaritja e tarifave të rrjetit, sipas nenit 14 e 16 mund të bëhet në bazë të analizave krahasuese të operatorëve të rrjetit në vendet fqinje. Operatori i rrjetit mund ta shfrytëzojë këtë opsion vetëm për 5 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie. Operatori i rrjetit do të paraqesë një vëzhgim mbi tarifat e rrjetit në vendet fqinje si dhe një vlerësim në lidhje me konkurrueshmërinë e çmimeve të klientëve fundorë që furnizohen me gaz natyror në Shqipëri, me të dhëna të sakta që mbështesin një vlerësim të tillë. Këto materiale duhet të përgatiten çdo vit dhe do t'i bashkohen dosjes së aplikimit për tarifë, sipas nenit 17.1.

ERE, në mënyrë të veçantë do të miratojë një përjashtim të tillë sipas nenit 17.3.

21.2 Nëse ndodh që mungojnë të dhënat nga vitet paraardhëse sipas nenit 4.4, për periudhën e parë rregullatore pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, operatori do të paraqesë një vlerësim me të dhëna të arsyeshme, gjatë aplikimit për tarifë.

21.3 Aplikimi i parë nga Shoqëria sipas kësaj metodologjie, do të jete jo më vonë se data 4 Dhjetor 2017.

21.4 Çdo amendim i Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” në lidhje me vendosjen e tarifave të rrjeteve të gazit apo mbulimit të kostove të rrjetit nuk do të ndikohet nga parashikimet e kësaj metodologjie.

22 Dispozita përfundimtare

Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, u miratua me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 178, datë 08.11.2017.

Aneksi 1

	Limiti i poshtëm	Limiti i sipërm
	Vitet	Vitet
Parcela Toke	∞	∞
Prona, Ndërtesa për Transport	25	35
Ndërtesa për Shoqërinë	50	60

Ndërtesa për Zyra	60	70
Hekurudha dhe vagona	23	27
Paisje Zyre (pa programet dhe paisjet shtesë)	8	10
Mjetet e punës/ paisjet	14	18
Magazinat	14	25
Paisjet kompjuterike	4	8
Programet kompjuterike	3	5
Makineritë e lehta	5	5
Makineritë e rënda	8	8
Depozitat e gazit	45	55
Ambientet e komprimimit të gazit		
Komprimimi i gazit	25	25
Ambientet e pastrimit të gazit	25	25
Tubacionet dhe montimi	25	25
Matja e gazit/ ambientet e matjes	25	25
Infrastruktura për sigurinë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Teknologjia e kontrollit të energjisë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ambientet ndihmëse (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ndërtesat, infrastruktura e transportit (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – veshja me polietilen)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – mbrojtja katodike)	55	65
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – izoluar me katrama)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (giza gri; Diametri Nominal > 150)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (forma të derdhura në fonderi)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (polietilen molekular me dendësi të lartë)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (PVC)	30	40
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (montime/ stacione montimi)	45	45
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (sondat pastruese të tubacioneve)	45	45
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (paisjet e sigurisë)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (matësit e sasisë së gazit)	8	16
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (rregullatori i trysnisë së gazit)	15	25

Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (paisjet matëse)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (paisjet kontrolluese)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (vendosja e paisjeve të sigurisë)	20	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (teknologjia e kontrollit të energjisë)	10	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (kompresorët në sistemin e përzierjes së gazit në varësi të afatit të përdorimit)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (sistemet ndihmëse)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (ndërtesat)	60	60
Sistemet e kontrollit në distancë	15	20